



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E ARSIMIT RINISË DHE SPORTIT**

PROCESVERBAL

**"KONSULTIM PUBLIK PËR MIRATIMIN E "PLANIT TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR 2026-2028"**

I mbajtur sot më **16.07.2025**, për miratimin e "Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028", në orën 09:00 në shkollën "Ahmet Zogu", lagjia 5 Bathore, dhe në orën 09:30 në kopshtin nr.15 "Borëbardha", Paskuqan.

Të pranishëm në takime ishin:

- Drejtoresha e Zyrës Vendore Arsimore Kamëz, znj. Albana Sulçe;
- Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Bashkisë Kamëz, znj. Aferdita Zefi;
- Antarë të Këshillit Bashkiak;
- Banorë të Njesisë Administrative Paskuqan, dhe Lagjeve Nr.1, 2 dhe Bathore;
- Shoqëri civile;
- Përfaqësues të Bashkisë Kamëz;
- Ndërlidhës me komunitetin;
- Përfaqësues të institucioneve publike dhe jopublike;
- Grupe interesi.

Konsultimet u hapën nga Drejtoresha e Zyrës Vendore Arsimore Kamëz, znj. Albana Sulçe e cila prezantoi qëllimin dhe objektivat kryesore të "Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028" për Bashkinë Kamëz. Ajo theksoi se ky plan synon përmirësimin e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes investimit në infrastrukturën e kopshteve, zhvillimit profesional të burimeve njerëzore dhe krijimit të një databaze

funkionale për menaxhimin efektiv të strukturave arsimore. Plani synon të harmonizojë aktivitetet në një vizion të përbashkët dhe koherent, duke përfshirë bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin.

Më pas, Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, znj. Aferdita Zefi, shtoi duke thënë që ky Plan është shtrirë në të gjitha institucionet arsimore nën juridiksionin territorial të Bashkisë Kamëz përfshirë, kopshte, shkolla 9- vjeçare dhe gjimnaze, që do të monitorohen nga Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, me qëllim përmirësimin e shërbimeve arsimore parauniversitare për të gjithë fëmijët e zonës.

Drejtoresha e Zyrës Vendore Arsimore Kamëz, znj. Albana Sulçe theksoi se Plani i Shërbimit për Arsimin Parauniversitar në Bashkinë Kamëz përqendrohet në Proceset e Menaxhimit të shërbimit në arsimin parauniversitar, me qëllim rritjen e cilësisë dhe organizimit efektiv. Planifikimi dhe kontrolli i cilësisë janë thelbësore për këtë qëllim, duke përfshirë planifikimin e numrit të fëmijëve në kopshte, shkolla dhe gjimnaze dhe vlerësimin e infrastrukturës së nevojshme.

Në vijim, Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, znj. Aferdita Zefi nënvizoi se plani përfshin edhe mbështetje të përditshme për të gjithë fëmijët në nevojë, përfshirë ndihmë ushqimore, trajtim psikologjik, si dhe ndërhyrje ligjore në rastet e nevojshme. Gjithashtu, synohet zbatimi i politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucionet arsimore dhe përmirësimi i bashkëpunimit mes strukturave të shërbimit social të përfshira për të garantuar një trajtim të drejtë dhe të efektshëm për të gjithë fëmijët në nevojë.

Pikat kryesore të trajtuara gjatë konsultimit të këtij plani ishin:

- Gjithpërfshirja, planifikimi dhe regjistrimi i fëmijëve
- Organizmat e institucionit arsimor
- Financimi
- Menaxhimi i godinave
- Burimet njerëzore
- Materialet dhe shërbime mbështetëse

Gjatë këtij konsultimi u zhvilluan gjithashtu bashkëbisedime me prindër të institucioneve arsimore të zonës;

- **A.Gj-** prind pranë shkollës “Ahmet Zogu”, e cila shprehi shqetësimin e saj lidhur me problematikën e fëmijëve gjatë kalimit të rrugës.
- **D. D-** prind pranë shkollës “Ahmet Zogu”, falenderoi për punët e bëra dhe veçanërisht përmirësimin e infrastrukturës arsimore.
- **S.H-** prind pranë shkollës “Ahmet Zogu”, kërkoi kufizimin e të drejtave të nxënësve pasi sipas tij nxënësit kanë të drejta të theksuara.
- **M.N-** prind pranë kopshtit nr.15 “Borëbardha”, falenderoi për krijimin e kopshteve me ushqim dhe përmirësimin e infrastrukturës së objekteve arsimore.

Takimi u mbyll me një falënderim të përzemërt nga Drejtoresha e Zyrës Vendore Arsimore Kamëz, znj. Albana Sulçe për pjesëmarrësit, duke i siguruar ata se çdo sugjerim i tyre do të merret parsyshë në implementimin e “Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028”.

Bashkëlidhur foto e konsultimeve .







